



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:153847

Datë: 20.08.2024

Numri i dokumentit: 06065178

C.nr.666/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, në çështjen juridike të paditësit N.Q nga Rahoveci, kundër të paditurve B.Z, F.Z, J.Z dhe Sh.Z, që të gjithë nga Rahoveci, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson avokati G.Sh nga Rahoveci, me objekt të kontestit vërtetimi i pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, vlera e objektit të kontestit 2000.00 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor më datën 20.08.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Në bazë të pohimit

I. APROVOHET NË TËRËSI e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.Q nga Rahoveci.

II. VËRTETOHET se paditësi N.Q nga Rahoveci, në bazë të parashkrimit fitues është pronar i paluajtshmërisë së evidentuar si njësi kadastrale me nr.P-71510057-04759-3, ZK Rahovec, komuna Rahovec, në vendin e quajtur “Carina”, me kulturë: Tokë Bujqësore – “Arë e klasës 4”, në sipërfaqe prej 1,698 m², e cila kufizohet në anën lindore me pikën zero, në anën Jugore me parcelën kadastrale nr. 4758-0 në gjatësi prej (pika 1-2) 7.90 m. +(pika 2-3) 14.39m, me parcelën kadastrale nr.4757-4 në gjatësi prej (pika 3-4) 20.73m. me parcelën kadastrale nr. 4757-3 (pika 4-5) 0.19m. + (pika 5-6) 15.99m. me parcelën kadastrale nr.4757-2 në gjatësi prej (pika 6-7) 7.05m. + (pika 7-8) 6.65m, dhe me parcelën kadastrale nr. 4757-1 në gjatësi prej (pika 8-9) 11.99m, në anën Perëndimore me parcelën kadastrale nr. 8727-0 (Rrugë publike) në gjatësi prej (pika 9-10) 29.10m. +(pika 10-11) 7.04m, dhe në anën Veriore me parcelën kadastrale nr. 4759-2 në gjatësi prej (pika 11-12) 76.73m dhe me parcelën kadastrale nr. 4759-1 në gjatësi prej (pika 12-1) 7.01m.

III. DETYROHEN të paditurit: B.Z, F.Z, J.Z dhe Sh.Z, që ta pranojnë këtë të drejtë dhe që të lejojnë regjistrimin e paluajtshmërisë P-71510057-04759-3, me sipërfaqe prej 1,698 m², ZK Rahovec në emër të paditësit N.Q në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Rahovecit, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi N.Q nga Rahoveci, në këtë gjykatë ka parashtruar padi kundër të paditurave B.Z, F.Z, J.Z dhe Sh.Z, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të parashkrimit fitues (mbajtjes) në paluatjshmërinë - parcelën me numër P-71510057-04759-3 me sipërfaqe prej 1,698 m², ZK Rahovec.

Paditësi si në padi ashtu edhe në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë të paraqitur me datë 09.07.2021 me të cilën ka kërkuar vërtetimin e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues pasi që parcela kadastrale me nr. P-71510057-04759-3 me sipërfaqe prej 1,698 m² ZK Rahovec, e ka blerë nga të paditurit me kontratë gojore në vitin 1995, të njëjtën paluejtshmëri e ka në posedim që nga ajo kohë, mirëpo nuk ka mundur ta bartë në regjistër të paluejtshmërive pasi që paditësit deri më tani nuk e kanë kryer trashëgiminë, andaj ka kërkuar nga gjykata që ta aprovojë kërkesëpadinë. Shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurve Avokati G.Sh, në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, ka theksuar faktin se me kohë e kanë pranuar ekspertizën ndaj të cilës nuk kanë vërejtje. Gjykata gjatë procedurës së provave e sidomos gjatë daljes në teren së bashku me ekspertin kanë vërtetuar se paditësi është në shfrytëzim të lirë të parcelës si në padi, po ashtu paditësi që nga viti 1995 nuk është penguar nga askush, në anën tjetër të gjitha obligimet ndaj të paditurve janë kryer me kohë, andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta aprovojë në tërësi si të bazuar pasi që janë plotësuar kushtet ligjore të Ligjit për pronë dhe të drejta tjera sendore. Shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike ka caktuar shqyrtimin kryesor në të cilin kanë prezantuar palët ndërgjyqëse. Ka caktuar ekspertizën e gjeodezisë dhe se bashku me palët ndërgjyqëse ka dalë në vend. Eksperti i gjeodezisë është obliguar që të bëjë identifikimin e parcelës, sipërfaqen, kufizimet e parcelës dhe kush është në shfrytëzim të saj.

Gjithashtu, për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave:

1. Certifikatën e pronës, e datës 06.07.2021;
2. Dëshmia e vdekjes së J (J) Z, i datës 12.07.2021;
3. Ekspertizën e gjeodezisë e ekspertit A.M, e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 16.07.2024.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar duke qenë se të paditurit e kanë pohuar kërkesëpadinë, që nga fillimi i procedurës e deri në përfundim të saj, ku të paditurit B.Z, F.Z, J.Z dhe Sh.Z, pohimin e kërkesëpadisë e kanë bërë përmes përfaqësuesit të autorizuar të tyre, në këtë rast avokatit të tyre.

Gjykata me administrimin e certifikatës së paluajtshmërisë P-71510057-04759-3, e datës 06.07.2021 dhe ekspertizës së gjeodezisë të datës 16.07.2024 (të cilave ua dha besimin e plotë) ka vërtetuar faktin se parcela nr. P-71510057-04759-3, me sipërfaqe prej 1,698 m², Zona Kadastrale Rahovec, evidentohet në emër të J.J.Z me pjesë ideale 1/1-tën.

Gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i çështjes, edhe përkundër pohimit të kërkesëpadsisë nga të paditurat, ka shtyrë marrjen e aktgjykimit në bazë të pohimit, kurse sipas propozimit të paditësit me qëllim të verifikimit dhe marrjes së njoftimeve të duhura në kuptim të nenit 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka caktuar seancën e vend shikimit dhe nxjerrjen e provës përmes ekspertizës së gjeodezisë.

Gjykata pas analizimit të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, thënieve në padi të paraqitur nga i padituri, ka gjetur se janë në harmoni me njëra tjetrën dhe me pohimin e palës së paditur, nga të cilat vërtetohen faktet relevante se palët mund të disponojnë me kërkesat e tyre, pasi që të paditurit janë të evidentuara si pronarë të paluajtshmërisë, që vërtetohet përmes certifikatës së pronës me nr. P-71510057-0759-3, e datës 06.07.2021.

Gjykata pas pohimit të kërkesëpadsisë nga ana e të paditurve përmes të autorizuarit të tyre, konstatoi se kërkesa është e disponueshme për palët, prandaj në kuptim të nenit 148.1 të Ligjit të procedurës Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se i padituri deri në përfundim të shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesën (aktgjykimi në bazë të pohimit)”,* vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Pasi që asnjëra nga palët ndërgjyqëse nuk kishte kërkuar shpenzimet procedurale, në kuptim të nenit 450 LPK-së, gjykata ka vendosur sikurse në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Mbi bazën e parashtrimeve të mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 dhe 148.1 të LPK-së.

GJYKATA E THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.666/2021 më datë 20.08.2024

Gjyqtari
Avni Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët mund të ushtrojnë ankese në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181 par.2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.